

ARTIKULAT

Artiklu 1. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 2. Përveç që ka qenë shumë më i lartë, tashmë

z gjetje

shpërbrojtja

z gjetje

z gjetje

z gjetje

z gjetje

z gjetje

Artiklu 3. Malaj Law Consulting and Statutet

I përfundim

Artiklu 4. Malaj Law Consulting and Statutet

I përfundim

Artiklu 5. Malaj Law Consulting and Statutet

I përfundim

Artiklu 6. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 7. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 8. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 9. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 10. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 11. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 12. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 13. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 14. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 15. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 16. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

Artiklu 17. Nominativi, Mbiqësia, Functi, Institucioni

I përfundim

AKT THEMELIMI & STATUTI MALAJ LAW CONSULTING AND PARTNER SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

PËRMBAJTJA

Kreu I	Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia
Neni 1	Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit
Neni 2	Objekti
Neni 3	Kohëzgjatja
Neni 4	Selia
Kreu II	Kapitali
Neni 5	Kapitali themeltar
Neni 6	Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit
Neni 7	Transferimi i kapitalit
KREU III	Organet Vendimarrese dhe Drejtuese
Neni 8	Organi Vendimmarres
Neni 9	Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme
Neni 10	Kuorumi
Neni 11	Marrja e vendimeve
Neni 12	Përjashtimi nga e drejta e votës
Neni 13	Administrimi
Neni 14	Kompetencat e Administratorëve
Neni 15	Pergjegjesite e Administratorit
KREU IV	Viti finansiar-Ekspertet
Neni 16	Viti Financiar
Neni 17	Ekspertet
KREU V	Prishja–Riorganizimi i shoqërisë
Neni 18	Prishja dhe likuidimi
Neni 19	Riorganizmi i shoqërisë, bashkimi-ndarja
Neni 20	Baza Ligjore
Neni 21	Mosmarrëveshjet

**AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MALAJ LAW CONSULTING AND PARTNER” SH.P.K**

KREUI I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, më date 07.12.2021, ne, themeluesit, kemi themeluar një shoqeri ne cilesine e një personi juridik shqiptar sipas formes “shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”. Shoqeria identifikohet nepermjet emrit te saj **“MALAJ LAW CONSULTING AND PARTNER” SH.P.K.**

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Flindi Malaj**, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, lindur më 16/01/1992, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit ID me numrin personal J20116084V.
- **Fatjon Malaj**, shtetas shqiptar, lindur me 10.04.1983 ne Vlore e banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me numrin personal I30410055K, madhor e me zotesi te plete per te vepruar, mbajtes i licences se avokatit nr. 10341.
- **Nora Malaj**, shtetase shqiptare, lindur me 29.11.1964 ne Tirane e banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit ID me numrin personal G46129084F, madhere e me zotesi te plete per te vepruar, mbajtese e licences se avokatit nr. 9017.
- **Dastid Kacmoli**, shtetas shqiptare, lindur me 28.01.2002 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtesi leternjoftimit ID me numrin personal K20128057Q, madhere e me zotesi te plete per te vepruar.

Neni 2

Objekti

2.1 Shoqeria Shoqeria do të krye aktivitetin e me poshtem : (i) perfaqesimin ligjor perpara prokurorise, policise, gjykatave penale, civile e administrative te çdo shkalle, ne emer e per llogari te personave fizik, juridik e publike; (ii) hartimi i akteve sipas permabatjes e formes te kerkuara nga ligji, per llogari te personave fizik, juridik e publike; (iii) punesimin apo marrjen ai avokate te jashtem te personave qe jane asistent avokate apo avokate per arritjen e qellimeve te shoqerise; (iv) punesimin e eksperteve te fushave te ndryshme per llogari te klienteve qe shoqeria ka apo proceseve gjyqesore ku shoqeria kryen perfaqesimin ligjor; (v) dhenien e konsulences per ligjin material e procedural penal, civil, administrativ; (vi) hartimin e akteve qe i paraqiten notereve ne emer e per llogari te personave fizik, juridik e publike; (vii) çdo lloj aktiviteti tjeter te lejuar nga ligji shqiptar.


2.2 Shoqeria mundet te realizoje çdo lloj operacioni finansiar apo tregtar, i cili lidhet ne menyre te drejtperdrejte ose jo me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per një afat te pacaktuar, perveç nese vendoset ndryshe nga organet drejtuese te saj.

**Neni 4
Selia**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Njesia Administrative nr. 5, Rruga “Abdyl Frashëri” nd. 7, kati 3, Tirane.



4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te dreje te krijoje dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit te Republikës se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.

KREU II
Kapitali
Neni 5
Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1.000 (nje mijë) Lekë, pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme tersishte te shlyera prej tyre:

- Ortaku themelues **Flladi Malaj**, eshte zoterues e 1 (një) kuote me vlerë 100 (njeqind) Leke që përfaqëson 9.9% (Nëntë.nëntë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues **Fatjon Malaj** është zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë 300 (treqind) Leke që përbën 30.1% (tridhjetë,një perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues **Nora Malaj** eshte zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë 300 (treqind) Leke që përbën 30% (tridhjete perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues **Dastid Kacmoli** eshte zoterues e 1 (një) kuote me vlerë 300 (treqind) Leke që përbën 30% (tridhjete perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit


- 6.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - shitblerjes;
 - trashëgimisë;
 - dhurimit;
 - çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
Organet Vendimarese dhe Drejtuese

Neni 8



Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 8.2 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - ndryshimet e statutit;
 - emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
 - pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veproje si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.


Neni 9 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51 për qind të kuotave.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjese ortak me të drejtë vote që zoteron 100 % te kapitali themeltar, pra nese marrin pjese ortakët që zoterojnë numrit total të votave personalisht apo votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11



4

Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çeshtje te tjera si:
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve;
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


Neni 13 Administrimi

- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 (pese) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 13.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.3 Personi i meposhtem caktohet si Administrator i shoqerise:

Fatjon Malaj, shtetas shqiptar, lindur me 10.04.1983 ne Vlore e banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me numrin personal I30410055K, madhor e me zotesi te plete per te vepruar, mbajtes i licences se avokatit nr. 10341

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

- 14.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpjekur asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpjekur asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2 Administratoret janë te detyruar te therrasin Asamblene e Përgjitheshme, në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponoje në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
- c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

14.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

14.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

14.5 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

15.1 Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administroimit të shoqërisë.

15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrate të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.4 Nëse administratori vpron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1, 2, 3 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

15.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

15.6 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.

15.7 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV Viti finanziar-Eksperter

Neni 16 Viti Financiar

16.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Eksperter

17.1 Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvektor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.


17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

KREU V Prishja riorganizimi i shoqërisë

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne edo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;



- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë ne përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".
- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19
Riorganizmi i shoqërisë, bashkimi-ndarja**

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20
Baza Ligjore**

- 20.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat ne fuqi te legjislacionit shqiptar.
- 20.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21
Mosmarrëveshjet**

21. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Republikës se Shqipërisë.

**U LEXUA, NËNSHKRUJA DHE MIRATUA
NGA ORTAKËT THEMELUES**

Flladi Malaj

Fatjon Malaj

Nora Malaj

Dastid Kacmoli

Nora Malaj

Dastid Kacmoli

[Signature]

[Signature]